

Mbledhja e datës 6 mars 2019

Grupi i Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” mbajti më datë 6 mars 2019 mbledhjen me rend dite shqyrtimin e raportit për veprimtarinë e grupit të deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” për vitin 2018, si edhe miratimin e kalendarit të punës për vitin 2019.

Në mbledhje morën pjesë, përveç deputetëve anëtarë të grupit “Miqtë e Fëmijëve”, Ministrja për Marrëdhëniet me Kuvendin znj. Elisa Spiropali, Ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë znj. Besa Shahini, Ministrja e Drejtësisë znj. Etilda Gjonaj, Ministrja e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Shoqërore znj. Ogerta Manastirliu, drejtues të agjencive shtetërore për mbrojtjen e fëmijëve si edhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe të organizatave ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve. Ishte i pranishëm edhe Përfaqësuesi i UNICEF-it në Shqipëri, z. Roberto de Bernardi.

Zëvendëskryetarja e Kuvendit dhe Zëvendëskryetare e Grupit “Miqtë e Fëmijëve”, znj. Vasilika Hysi, prezantoi raportin vjetor dhe kalendarin e punës dhe të aktiviteteve për vitin 2019 dhe theksoi se gjatë vitit 2018, është konstatuar një rritje e ndërgjegjësimit dhe ndjeshmërisë së deputetëve, jo vetëm anëtarëve të grupit “Miqtë e Fëmijëve”, por të të gjithë deputetëve të Kuvendit, në funksion të krijimit të një klime mbështetëse për çështjen e fëmijëve.

Në përfundim të shqyrtimit të raportit dhe diskutimeve Kryetari i Kuvendit, njëkohësisht Kryetar i grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, vuri theksin në disa çështje prioritare të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Z. Ruçi vlerësoi arritjet e GMDF, dhe kontributin nëpërmjet angazhimit të vazhdueshëm të shoqërisë civile për të drejtat e fëmijëve dhe sugjeroi hartimin e një Rezolutë të Kuvendit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, e cila do të specifikojë detyrimet në këtë aspekt për të gjithë institucionet dhe aktorët: Kuvendin dhe komisionet parlamentare, Qeverinë, pushtetin vendor, shoqërinë civile, Avokatin e Popullit dhe institucionet dhe agjencitë e tjera. Kjo rezolutë do të ndihmojë në realizimin e adresimit të problemeve të fëmijëve sipas shkallës së rreziqeve dhe nevojave të tyre specifike, duke synuar trajtimin e problematikave të tyre derisa hyjnë në jetën e pavarur.